



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

BUXHETI 2018

Një vështrim për qytetarët





Z. Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
dhe Ekonomisë

Mesazh për lexuesin

Të dashur qytetarë,

Buxheti 2018 është platforma kryesore ku mbështetet konsolidimi i rritjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm, vazhdimi të uljes së borxhit publik, rritjes së mëtejshme të investimeve publike, avancimit të reformave dhe mbështetjes së sektorëve, me fokus rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Rritja ekonomike në vitin 2018 parashikohet të jetë 4,2% në vazhdim të rritjes pozitive në pragun e 4% në gjysmën e parë të vitit 2017, dhe mbi katër herë më shumë se 1% në vitin 2013.

Buxheti 2018 vijon konsolidimin makroekonomik e fiskal, duke ulur më tej borxhin publik për të dytin vit radhazi, në nivelin 68,6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Rritja e konsumit dhe investimeve private, reflektuar në rritjen e besimit të biznesit dhe konsumatorit në ekonomi si dhe vlerësimet e partnerëve ndërkombëtarë, janë tregues të rëndësishëm për ecurinë pozitive të menaxhimit të financave publike dhe impaktin e reformave kyçe strukturore.

Buxheti 2018 parashikon paketën më të madhe të investimeve në historinë e vendit, me mbi 5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, pa përfshirë investimet e bashkive.

Ai garanton progresin për reformat e sektorët kyç të ekonomisë: rrugë kombëtare e turistike, ujësjellës, qendra shëndetësore, shkolla e libra falas për nxënësit e fillores, më shumë financime për nxitjen e eksporteve bujqësore dhe Policinë e Shtetit dhe Reformën në Drejtësi.

Ky është një buxhet për qytetarin: 1 miliard lekë janë parashikuar më 2018 për politikën e rritjes së pagave, me fokus arsimin dhe shëndetësinë. Skema e re e dyfishon masën e pagesës në mesatarisht 5 600 lekë në muaj për pothuaj 80 mijë familje, nga 1000 e 3500 lekë më parë, ndërsa mbi 160 mijë persona do të trajtohen me pagesa të aftësisë së kufizuar.

Përmirësimi i shërbimeve publike, rritja e aksesit, thjeshtimi i procedurave administrative për sipërmarrjen e qytetarët, përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve, ulja e borxhit publik dhe reformat, përbëjnë platformën mbi të cilën mbështetet aspirata europiane e qytetarëve shqiptarë, tashmë më afër se asnjëherë tjetër.

Ekonomia vijon rritjen




Rritje reale e PBB-së prej mbi 4% në katër vitet në vazhdim




Rritje e investimeve të qeverisë në favor të rritjes së mirëqenies së qytetarëve, uljes së varfërisë, rritjes së punësimit dhe barazisë

Rritja e PBB reale (rritja vjetore në %)



Buxheti 2018 mbështetet në premisat pozitive të vitit 2017 për të rritur mirëqenien e qytetarëve shqiptarë duke bërë të mundur rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

TREGUES POZITIVË MAKROEKONOMIKË:



Prodhimi i Brendshëm Bruto:
1 650 miliardë lekë



Rritja reale:
4,2% e PBB-së



Inflacioni:
2,3% në vit

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET

Buxheti 2018 garanton uljen e deficitit fiskal për të dytin vit radhazi, me 2,5% të PBB-së: borxhi publik vazhdon trajektoren rënëse. Parashikohet që borxhi të bjerë nën nivelin 60% të PBB-së deri në vitin 2020.

Të ardhurat:

464 miliardë lekë

Deficiti buxhetor

Shpenzimet:

496 miliardë lekë

32 miliardë lekë
(ose **2% e PBB-së**)

PUNËSIMI ËSHTË NË RRRITJE




Mbi 200 mijë vende të reja pune u krijuan në ekonomi në katër vitet e fundit. Në vitin 2018, pritet që papunësia të ulet nën nivelin 13% dhe nën 10% deri në vitin 2021.



1 miliard lekë për rritje e pagave, me fokus në arsim dhe shëndetësi.

Shkalla e papunësisë (% , tremujor)




Synimi i buxhetit është të stimulojë rritjen duke investuar më shumë në ekonomi dhe në infrastrukturë, duke krijuar vende pune, duke përmirësuar shërbimet për qytetarët dhe duke u dhënë frymëmarrje ekonomisë dhe ndërmarrjeve në sektorë strategjikë për rritjen e punësimit dhe konkurrueshmërisë.



NGA VIJNË PARATË E BUXHETIT?


- Të ardhurat përbëjnë **28,1%** të PBB-së
- Të ardhurat nga sistemi fiskal përbëjnë **25,8%** të PBB-së
- Tatimi i fitimit për ndërmarrjet dhe akciza përbëjnë **70%** të të ardhurave tatimore në buxhetin 2018

Të ardhurat e buxhetit parashikohen në rritje, falë efektit të rritjes ekonomike, politikave fiskale dhe pajtimin e tatimpaguesve me ligjin:



KU SHKOJNË PARATË E BUXHETIT?

Arsimi, shëndetësia dhe mbrojtja sociale përbëjnë mbi 48% të shpenzimeve të buxhetit më 2018.



Administrata	36,5	miliardë lekë
Mbrojtja	11,7	miliardë lekë
Rendi publik	28,8	miliardë lekë
Ekonomia (transporti, bujqësia, industria...)	45,8	miliardë lekë
Mjedisi	1,2	miliardë lekë
Uji dhe strehimi	31,4	miliardë lekë
Shëndetësia	48,6	miliardë lekë
Kultura	3,4	miliardë lekë
Arsimi	41,0	miliardë lekë
Mbrojtja Sociale	148,6	miliardë lekë
Të tjera	136,1	miliardë lekë



ARSIMI

Buxheti 2018 është rritur me 3,6 miliardë lekë, ose 10,52% nga 2017



48% më shumë investime

- 160 shkolla të ndërtuara e të rindërtuara në 4 vjet dhe 34 shkolla të reja me buxhetin 2018



Cilësi në arsim:

- Rishikimi i teksteve shkollore: fëmijët mësojnë me tekste të Cambridge, Oxford e Pearson si bashkëmohatarët në Europë
- Trajnim i 9 000 mësuesve për kurrikulën e re
- Furnizim me 40 000 libra për bibliotekat e shkollave



Vëmendje për fëmijët me nevoja të veçanta:

- Dyfishim i mësuesve ndihmës në krahasim me 2017: në vitin 2018 do të ketë 620 mësues ndihmës në të gjithë vendin



Vëmendje për nxënësit dhe familjet:

- Tekste falas për 240 mijë nxënës
- Transport falas për 30 mijë nxënës dhe 11 mijë mësues
- **50 shkolla të reja komunitare: 275 shkolla komunitare gjithsej në vitin 2018**
- **400 milionë lekë për mbështetje të studentëve ekselentë dhe atyre me nevoja sociale**



SHËNDETËSIA

Buxheti 2018 është rritur me 48 miliardë lekë në krahasim me 2017



704 milionë lekë, ose 35% më shumë investime se në vitin 2017

- 90 qendra shëndetësore e ambulanca sipas standardeve europiane do të ndërtohen në vitin 2018, duke arritur 300 të tilla në të gjithë vendin deri më 2020
- Ndërtimi i spitalit rajonal të Fierit, si pjesë e programit “1 miliard”



Shërbim i integruar i instrumenteve kirurgjikale dhe sterilizimit sipas standardeve europiane në çdo sallë operacionesh



Rritje e pagave në shëndetësi:

- Rritje deri 5% për 18 mijë mjekë dhe infermierë përtej rritjes së deritanishme. Paga mesatare e infermierëve është rritur mesatarisht me 23% që nga viti 2013
- Dyfishim i bonusit dhe incentiva financiare për mjekët



MBROJTJA SOCIALE



23 miliardë lekë në buxhetin 2018 për mbrojtjen sociale, ose 255 milionë lekë më shumë se në vitin 2017.



20,5 miliardë lekë për mbështetjen e familjeve në nevojë dhe individëve me aftësi të veçanta



Rreth 80 mijë familje do të përfitojnë nga skema e re e ndihmës ekonomike:

- Pagesat e ndihmës ekonomike rriten 2-3 herë në krahasim me vitin 2017
- Mund të përfitojnë edhe familjet në fshat, që kanë tokë bujqësore, por që janë në nevojë



Mbi 164 mijë persona do të trajtohen me pagesa të aftësisë së kufizuar



Rritje e pagesës së papunësisë: 5 500 të papunë do të përfitojnë në 2018, nga 6 000 në vitin 2017, edhe për shkak të rënies së papunësisë

INFRASTRUKTURA

Buxheti 2018 parashikon 42% më shumë investime në infrastrukturë se një vit më parë.



Infrastruktura e nevojshme për të mbështetur rritjen ekonomike: Buxheti 2018 ka paketën më të madhe të investimeve në rrugë kombëtare, rajonale e turistike, ujësjellës.

- Mbi 22 miliardë lekë, ose ¼ e investimeve në rrugë kombëtare
- Mbi 26 miliardë lekë në infrastrukturë rajonale e rurale: rrugë e ujësjellës
- Mbi 3 miliardë lekë për mirëmbajtjen e bazhdueshme të rrugëve

Disa nga projektet kryesore që do të financohen me buxhetin 2018:

- Ndërtimi i rrugës së Arbrit (Programi “1 miliard” për rindërtim)
- Vazhdimi i Unazës së Tiranës
- Ndërtimi i rrugës Thumanë-Vorë (pjesë e aksit kombëtar rrugor Durrës-Kukës-Morinë)



Investime në sektorin e ujit të pijshëm:

- 10 miliardë lekë investime në vitin 2018 në infrastrukturën e ujit të pijshëm
- 1 milion lekë subvencione për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, për t'u transferuar në periudhën afatmesme në një skemë mbështetëse për familjet në nevojë
- Rritje e furnizimit me ujë në mesatarisht 14 orë në ditë dhe ulje e humbjeve



BUJQËSIA

Buxheti 2018 për bujqësinë rritet me 15% ose 1,4 miliardë më shumë se më 2017:



Më shumë kujdes për burimet natyrore, peshkimin e sigurinë ushqimore:

- Rritje 10% për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit
- Rritje 46% për menaxhimin e peshkimit



Mbështetje me subvencione për bujqësinë: 2,6 miliardë lekë financime për fermerët, ose 55% më shumë se më 2017:

- 5 600 fermerë përfitues më 2017
- 14 mijë fermerë përfitues më 2018

